



DEPARTAMENTI I AKTEVE RREGULLATRE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA  
Drejtoria RIA dhe e Konsultimit Publik

Tiranë, 15 dhjetor 2025

**VLERËSIM**

**Lënda:** Vlerësim i draft raportit të ndikimit rregulator (RIA) për projektligjin “Për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare”.

Vlerësimi i përgjithshëm: 89/100

Përgjithësisht pozitiv



**A) Informacione të përgjithshme mbi procesin**

**Emërtimi i propozimit të politikës**

Projektligji “Për shndërrimet, bashkimet dhe ndarjet ndërkufitare të shoqërive tregtare”

<b>Ministria udhëheqëse</b>	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
<b>Numri/data e RIAs</b>	2025 – MEI – Nr.11
<b>Statusi</b>	Finale
<b>Data e marrjes për shqyrtim</b>	11 gusht 2025
<b>Data e komenteve të fundit</b>	12 dhjetor 2025
<b>Numri i komenteve të kryera/të reflektuara</b>	20/21
<b>Numri i ripunimeve</b>	3

**A) Konteksti i politikës**

Qëllimi i kësaj nisme është krijimi i një kuadri të plotë ligjor që rregullon kushtet, procedurat dhe pasojat juridike të shndërrimeve, bashkimeve dhe ndarjeve ndërkufitare ndërmjet shoqërive tregtare shqiptare dhe atyre të vendeve të Bashkimit Evropian. Projektligji përcakton rregulla të unifikuara për kryerjen e këtyre operacioneve ndërkufitare, duke garantuar siguri juridike, transparencë dhe trajtim të barabartë për subjektet e përfshira.

**B) Vlerësimi i përgjithshëm**

Drejtoria vlerëson përpjekjet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për të siguruar se ndërhyrja e qeverisë është e orientuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate sa më të mira me një barrë dhe kosto minimale rregullatore dhe administrative.

*Për arsyet e lartpërmendura, Drejtoria vlerëson se raporti RIA, në versionin aktual, është përgjithësisht në përputhje me metodologjinë e vlerësimit të ndikimit. Institucioni ka evidentuar problemet duke shpjeguar shkaqet dhe efektet e tyre; grupet e prekura; arsyet e ndërhyrjes dhe lidhjen e nismës me objektivat e nivelit të lartë. Njëkohësisht, është kryer një analizë mjaftueshmërisht cilësore mbi ndikimet e mundshme ekonomike/financiare dhe sociale, të opsionit të preferuar. Gjithashtu, çështjet që lidhen me zbatimin e opsionit të preferuar dhe monitorimin e ecurisë së arritjes së objektivave të vendosura janë trajtuar në një mënyrë përgjithësisht të detajuar*

### **C) Rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të RIAs**

Në vijim të gjetjeve të lartpërmendura, konsiderojmë se në mënyrë që RIA të jetë *plotësisht* në përputhje me kriteret e përcaktuara nga metodologjia, nga ana e strukturës hartuese duhet:

1. Të thellohet më tej analiza ekonomike sasiore ekonomike (kosto/përfitimi), për të gjitha grupet e prekura.
2. Te redaktohet nga ana gramatikore raporti për të përmirësuar qartësinë e tij.